



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 12 datë 25.02 2022

Për miratimin e rinovimit të kontratës së dhënies me qira të fondit pyjor për antene të telefonisë celulare në ngastrën 118b, Ek. Pyjore Shllak 2, subjektit “ALBtelekom” sh. a.

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”, neni 25, **pika 49** e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” *me shumicë të cilësuar votash.*

V E N D O S I

1. Miratimin e rinovimit të kontratës nr.7521, Datë 22.12.2020 “për dhënie me qira të fondit Pyjor për ngastrën nr .118b Ekonomia pyjore shllak 2 ,me sipërfaqe **0.02 ha** për antene për komunikime elektronike, publike, telefoni celulare, si dhe rrugë kalimi me gjatësi 0.2 km nga Subjektit “**ALBtelekom**” sh a, **Temal** sipas raportit teknik, relacionit dhe hartës bashkëlidhur.
2. Afati i kontratës të jetë 5 vjet.
3. Efektet: Jep impaktë pozitive tek subjekti/komuniteti duke rigjeneruar të ardhura , sigurohen të ardhura tek Bashkia të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
4. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas studimit tekniko-ekonomik bashkëlidhur, sipas VKM, Nr. 1064, dt. 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”.
5. Ngarkohen Drejtoria e pyjeve, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

K R Y E T A R

Mark Bisha

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ardian Çelepija

Miratuar me 25 vota

Vota Pro 25

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 03.03 2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT
Sektori i menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

Nr. 13 prot.

Vau Dejës, më 14.02.2022

RELACION

RINOVIM KONTRATE TË DHËNIES ME QIRA TE FONDIT PYJOR SUBJEKTIT
“ALBTELECOM” Sh.A, STACIONI **KK1011** TEMAL PËR ANTENË TË TELEFONISE
CELULARE.

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia **Vau i Dejës**, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të cilët është edhe administrimi i pyjeve dhe kullotave vendore sipas mënyrës së përcaktuar me ligj ka në administrimin e saj gjithsej 31 118.2 ha. Pjesë e këtij administrimi është edhe dhënia me qera/përdorim e këtij fondi pyjor nëpërmjet të tretëve.

Kompania **ALBtelekom**”sha, ka lidhur Kontratën e Qerasë për përdorimin e fondit pyjor/kullosor për antenën e komunikimit të telefonisë celulare **ALBtelekom** e ndodhur në Gushte Temal,Njësia Admiunistrative Temal,stacioni **nr. KK 1011** me nr.**7521**.Prot,datë 22.12.2020 me afat deri me 21.12.2021 .

Kontrata e qerasë (përdorimit) për sipërfaqen pyjore prej 0.02 ha në fshatin gushtë e ndodhur në Ekonominë Pyjore Shllak 2,ka qënë e lidhur me Bashkinë Vau Dejës me afat përdorimi një vjeçar e cila ka perfunduar.

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar pranë Bashkisë Vau i Dejës/ Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave , rezulton që parcela në të cilën është e ndërtuar kjo antenë komunikimi , është pjese e inventarit të pronave të Bashkisë Vau i Dejës , kjo bazuar në në VKM nr. 433 dt 08.06.2016 i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të MM e të ish komunave/bashkive”, me nr Ngastre 118 b dhe bën pjesë në ekonomine pyjore **Shllak 2**,sipas listes së inventarit, **shtojca nr.47** me numër rendor **1128**.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.2 c , neni 54 pika el, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë ,tjetërsimi apo dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “ Për rregullat , procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” , pika 22/g , përjashton nga konkurimi publik dhënien në përdorim të sipërfaqeve për ndërtimin e antenave të komunikimit radiotelevizive dhe telefonisë celulare.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria **ALBtelekom**” sha është konform pikës 22 g të këtij Udhëzimi,pikes 24 dhe përbëhet nga:

- a) leja/licenca përkatëse nga institucioni qendror për ushtrimin e veprimtarisë;
- b) kontratat ekzistuese të lidhura Bashkine Vau Dejës.
- c) projektin teknik të zbatimit
- d) hartën topografike me kordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në formatin PDF dhe në format elektronik në shkallën 1:10000 ku janë evidentuar elementet kryesore, si: zona kadastrale sipas ZRPP-së, kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, si dhe lidhjen me të dhënat për treguesit kadastralë pyjorë dhe kullosorë;
- e) lejen e mjedisit.
- f) lejen e ndërtimit;
- g) aktin e regjistrimit pranë QKR-së.

Bazuar në ligjin nr 57/2020 “Për pyjet “datë 30.04.2020, VKM nr. 1064 datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391/2006 “ Për tarifat në shërbimin pyjor/kullosor i ndryshuar , lidhja 2 pika 7,5 në bazë të “përdorimit të territorit” dhe afatit të dhënies në përdorim janë përcaktuar tarifat si më poshtë:

7. Për vendosje antene të telefonisë fikse, të lëvizëshme, televizive, radio-komunikimit				
Nr.	Përdorimi i territorit	Siperfaqia e perdorur ne ha	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit	
			1-5 vjet	6-10 vjet
5	Toke Inproduktive (shkembore)	0.02	5 500 000	5 000 000

Ne funksion te siperfaqes që merret në përdorim,subjekti ka servitut edhe përdorimin e rrugës,0.2 km,të cilat sipas VKM 1064,Lidhja 2,Pika;12 /5,Tarifohet si më poshte:

12. Për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues			
Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqia e përdorur në km	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/km/vit
5	Toke Inproduktive (shkembore)	0.2	25 000

Ne total 115 000 (Njënqind e pesëmbëdhjetë mijë) leke.

Bazuar në sa më sipër propozojmë miratimin e dhënies në përdorim me qera për një afat 5 vjecar, për shfrytëzimin e sipërfaqes inproduktive ngastra nr 118b ekonomia pyjore Shllak 2 sipas të dhënave të sipërcituara.

Duke ju falenderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit

Specialistet

Mark Suli

Zeqir Ujka


Miratoi

Drejtori

RROK FIONI

Azhonuar dt. 23.06.2020.

Koordinatat jane ne sistemin UTM Zone 34N



Legjendë

	antene
	rruge

Studio "BYLIS HOLDING"
Top. GJERGJI BEGA
Nr.Liq. T.0659/1

PERGATITI

STUDIO "BYLIS HOLDING"

PROJEKTIM - KONSTRUKSION - TOPOGRAFI

LICENCE: T.0659/1 04/09/2019

KATEGORIA 8/b

DATA E PERGATITJES 23/06/2020




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR



Nr. 1168/Prot

Dt. 11.03.22



Nr.166/1 prot

Shkodër, më 09/03/2022

LËNDA: Mbi vendimin nr.12, datë 25.02.2022 të Këshillit Bashkiak Vau-Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU- DEJËS


Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 datë 9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institutcionit të Prefektit të Qarkut” aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9/1/ 1.2/c, neni 27, neni 54/e/1, neni 55/3, ligjit Nr.57/2020 “Per pyjet”, VKM Nr.684 dt.2.09.2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.433 dt.8.06.2016 ”Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrise së Mjedisit e të ish Komunave dhe Bashkive”, i ndryshuar, pika 49, shtojca 47, VKM Nr.1064 dt.22.12.2010 Per disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” pika 22/g, lidhja II, pika 7, analizoi **VKB Vau-Dejës** nr.12, datë 25.02.2022 sipas dokumentacionit bashkëlidhur “Për dhënien me qera¹ për një periudhë 5 (pesë) vjeçare të fondit pyjor (lloji shkëmbore) për vendosje antene të telefonisë celulare në ngastrën 118b, ekonomia pyjore Shllak 2, subjektit “Altelecom”.

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Në vemendje të strukturës përgjegjëse, monitoruese kriteret dhe kushtet ligjore të përcaktuara në ligjin Nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në RSH” i ndryshuar dhe ligjin nr.10431 datë 9.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar neni 40.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

PREFEKTI
NË MËNGESË
SEKRETARI PËRÇJITHSHËM
Felek KASEMI



¹ Rinovim kontrate terminologji e gabuar për këshillin bashkiak